

Nr. 36/12 Prot  
02.08.2023

Raporti i Audituesve të Pavarur  
dhe

Pasqyra e Ndryshimit të Kapitalit Themeltar të  
Regjistruar

**“ALBAFILM” Sh.A**

2 Gusht 2023

# Përmbajtja

## **RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN THEMELTAR**

---

Olti Visha CPA,  
Auditues Ligjor Lic. Nr.455 datë 06.02.2020

Elvira Hoxha CPA,  
Auditues Ligjor Lic. Nr.198 datë 28.12.2008

# Raporti i Audituesve të Pavarur

Për Ministrin e Kulturës (Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit)

Me cilësinë e Audituesve Ligjorë të caktuar me vendimin 3809/1 datë 25 korrik 2023 të Ministrisë të Kulturës, të marrë në kuadër të zbatimit të projektit "Rehabilitimi i Qendrës Kinostudio" të miratuar me vendimin e Këshillit Teknik nr. 9/1 datë 30.05.2023 të Bashkisë Tiranë, ne kemi kryer procedurat e rëna dakort, lidhur me ndryshimet në kapitalin themeltar të "ALBAFILM" Sh.A (këtu e më poshtë referuar si Shoqëria).

Angazhimi ynë është kryer sipas dispozitave të përcaktuara në Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Angazhimi ynë u krye në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Shërbimet të Tjera të Dhënies së Sigurisë (ISRS 4400) të aplikueshme në lidhje me procedura të rëna dakord. Këto procedura u kryen për të asistuar Shoqërinë në lidhje me përlogaritjen e zvogëlimit dhe gjendjes së kapitalit themeltar specifikuar si më poshtë:

1. Ne rishikuar Vendimin datë 25 Korrik 2023 të ortakut të vetëm të "ALBAFILM" Sh.A për zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë në shumën 284.000 Lekë, (nga 847,774,000 lekë në 847.490.000 lekë). Zvogëlimi i kapitalit do të kryhet për arsye se për realizimin e zbatimit të projektit "Rehabilitimi i Qendrës Kinostudio" të miratuar me vendimin nr. 11/5 datë 19.07.2022 të Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë, shoqërisë "Albafilm" Sh.a i prishen disa objekte të ndodhura në territorin e saj të cilat përcaktohen në planimetrinë e prishjeve të projekt zbatimit. Ne rishikuar gjithashtu vendimin nr. 298 datë 16.05.2023 të Asamblesë së Aksionarit për miratimin e raportit të auditimit dhe shpërndarjen e rezultatit financiar për vitin 2022 të shoqërisë "Albafilm" Sh.A. Vlera e kapitalit në shumën 847.774.000 është pasqyruar në Pasqyrat Financiare 2022.
2. Ne rishikuar ekstraktin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të kapitalit themeltar të shoqërisë para zvogëlimit, sipas të cilit Ministria e Kulturës është zotëruese 100% e kapitalit të shoqërisë me vlerë 847.774.000 lekë dhe pasqyrat financiare të shoqërisë më 31.12.2022 për të verifikuar gjendjen e kapitalit themeltar para zvogëlimit.
3. Ne kryem rillogaritje të pasqyrës së kapitalit themeltar të Shoqërisë pas zvogëlimit, post i cili paraqitet në Pasqyrën e Ndryshimeve në Kapital në vijim të këtij raporti.

Olti Visha CPA,  
Auditues Ligjor Lic. Nr.455 datë 06.02.2020

Elvira Hoxha CPA,  
Auditues Ligjor Lic. Nr.198 datë 28.12.2008

Në bazë të procedurave të kryera, konkluzionet tona janë si më poshtë:

Ne konstatuam se:

1. Në pasqyrat financiare të shoqërisë të vitit 2022 - Pasqyra e Pozicionit Financiar, në postin "Fitimi (humbja) e periudhës", është në Shumën 1.339.257 lekë.

Sipas vendimit të datës 16.05.2023 të Asamblesë së Aksionarit, nga fitimi i Vitit 2022 në vlerën 1.339.257 lekë (një milion e treqind e tridhjetë e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë e shtatë lekë):

- Do të kalojë në rezervë ligjore 5% në vlerën 66.963 lekë;
- Do të kalojë Divident 10% në vlerën 133.926 lekë:
  - Dega e Tatim Taksave 15% e dividendit në Shumën 20.089 lekë;
  - Buxheti i Shtetit 85% e Dividentit në vlerën 113.837 lekë;
- Do të kalojë Rezervë zhvillimi 85% në Shumën 1.138.368 lekë.

Nga rishikimi i Pasqyrave Financiare 2022 dhe vendimit të ortakut të vetëm nuk u konstatuan diferenca.

2. Ne rishikuar gjendjen e kapitalit themeltar të shoqërisë para zmadhimit dhe nuk identifikuar diferenca. Vlera e kapitalit e paraqitur në bilanc në datën 31.12.2022 është 847.774.000 Lek, e njëjta gjendje e kapitalit është paraqitur edhe në ekstraktin e QKB në date 25.07.2023.

Pasqyra e Pozicionit Financiar që mbyllet më 31.12.2022, ka të dhënat e mëposhtme:

	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
<b>Aktivi</b>		
Aktive afatshkurtra	665,978,115	652,239,241
Aktive afatgjata	337,811,699	398,387,819
<b>Totali i Aktiveve</b>	<b>1,003,789,814</b>	<b>1,050,627,060</b>
<b>Pasivi</b>		
Kapitalet dhe Rezervat		
Kapitali nënshkruar	847,774,000	895,701,000
Primi i lidhur me kapitalin		
Rezerva të tjera		
<i>Rezerva ligjore</i>		
<i>Rezerva statutore</i>		
<i>Rezerva të tjera</i>	118,836,343	112,035,898
Fitimi (humbja) i pashpërndarë		
Fitimi (humbja) e periudhës	1,339,257	7,556,050
	<b>967,949,600</b>	<b>1,015,292,948</b>
Detyrime afatshkurtra	35,840,214	35,334,112
Detyrime afatgjata		
	<b>35,840,214</b>	<b>35,334,112</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>	<b>1,003,789,814</b>	<b>1,050,627,060</b>

3. Nga rillogaritja e pasqyrës së kapitalit themeltar të Shoqërisë pas zvogëlimit e cila paraqitet në Pasqyrën e Ndryshimeve të Kapitalit Themeltar në vijim të këtij Raporti nuk u konstatuan diferenca.

Duke qenë se procedurat e mësipërme nuk përbëjnë procedura auditimi apo rishikimi të pasqyrave financiare të kryera në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit apo Standardeve Ndërkombëtare për Shërbime të Rishikimit apo edhe të Standardeve apo Praktikave Kombëtare, ne nuk shprehim siguri në lidhje me Pasqyrën e Ndryshimeve në Kapital më 25 Korrik 2023.

Nëse do të kishim kryer procedura shtesë apo kishim kryer auditim ose rishikim të Pasqyrave Financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit apo Standardeve Ndërkombëtare për Shërbime të Rishikimit, çështje të tjera mund të kishin ardhur në vëmendjen tonë që do të ishin raportuar te Ju.

#### *Kufizimi i përdorimit*

Raporti ynë është vetëm për qëllimin e përcaktuar në paragrafin e parë të këtij raporti dhe për përdorimin tuaj dhe nuk duhet të përdoret për asnjë qëllim tjetër apo t'u shpërndahet Palëve të Treta, përveç depozitimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Shqipëri. Ky raport lidhet vetëm me çështjet e përmendura më lart dhe nuk shtrihet për ndonjë Pasqyrë Financiare të Shoqërisë si një e tërë.

#### **Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin themeltar**

Me Vendimin datë 25 Korrik 2023 të Asamblesë së Aksionarit të shoqërisë "ALBAFILM" Sh.A mbajtur në adresën Rruga "Aleksandër Moisiu", nr. 76, ish Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë, Republika e Shqipërisë, në mbështetje të Ligjit nr. 7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare" (i ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 711 datë 09.09.2020 "Për transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë", ligjit nr. 10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar si dhe Statutit të shoqërisë, u vendos emërimi i audituesve ligjore z. Olti Visha dhe zj. Elvira Hoxha të cilët së bashku do të kryejnë veprimet e nevojshme për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë Albafilm Sh.a.

#### **Zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërisë "ALBAFILM" Sh.A**

Bazuar në Pasqyrat Financiare të shoqërisë vlera e aktiveve afatgjata materiale në 31.12.2022 është në shumën 337.775.783 lekë.

Sic bëhet me dije nëpërmjet shkresave nr. 4722 Prot. datë 02.02.2023 "Për informacion" dhe Nr. 23615 Prot. datë 26.06.2023 "Për dijeni tuaj" të dërguara nga Drejtoria e Investimeve të Punëve Publike të Bashkisë Tiranë, drejtuar shoqërisë "Albafilm" Sh.a, në sipërfaqen e territorit të shoqërisë "Albafilm" Sh.a ndodhen disa objekte të cilat parashikohen të prishen për të vënë në zbatim projektin e Rehabilitimit të Qendrës së Kinostudios e cila ka për qëllim rikonstruksionin e rrugës "Aleksandër Moisiu", rritjen e sipërfaqeve të gjelbra dhe krijimin e hapësirave rekreative për fëmijet, rregullimin e qarkullimit në rrugët lidhëse etj.

Në këtë sipërfaqe objektet të cilat do të prishen paraqiten në tabelën më poshtë:

**Amortizimi i Aseteve të llogarisë 2121 (Objekte ndërtimore) më 31.07.2023**

Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Amortizimi më 31.12.2022 (Norma e amortizimit 5 % mbi vlerë mbetur)	Vlera e mbetur më 31.12.2022	Pakësim gjatë vitit 2023	Zbritje e amortizimit si rezultat i pakësimeve	Shtesa gjatë vitit 2023	Amortizimi për vitin 2023	Amortizimi progresiv	Vlera e mbetur më 31.07.2023
Vendroja	Cope	1	320,355	320,355	269,452	50,903				1,485	270,937	49,418
Depo afer vendrojes	Cope	1	64,071	64,071	53,359	10,712				312	53,671	10,400
Oficina e transportit	Cope	1	1,377,527	1,377,527	1,147,124	230,403				6,221	1,153,345	224,182
<b>Shuma</b>				<b>1,761,953</b>	<b>1,469,935</b>	<b>292,018</b>	-	-	-	<b>8,018</b>	<b>1,477,953</b>	<b>284,000</b>

Në zbatim të Vendimit nr. 3809/1 datë 25.07.2023 të Ministrit të Kulturës, **Kapitali i Shoqërisë zvogëlohet për shumën 284.000 lekë.**

Rekomandojmë që të bëhet rifreskimi i kartelës së pasurisë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë dhe pasuria Truall e shoqërisë "Albafilm" Sh.a të zvogëlohet me vlerën proporcionale të ndërtesave të cilat janë prishur dhe të bëhet regjistrimi në kartelën e re pas kalimit të sipërfaqes së truallit për Bashkinë Tiranë.

Kapitali aksionar i shoqërisë i regjistruar para ndryshimit ..... 847.774.000  
 Kapitali zvogëlohet për vlerën e objekteve të prishura .....284.000  
 Kapitali aksionar i shoqërisë pas ndryshimeve .....847.490.000

Për sa më sipër, pas destinimit të fitimit të pashpërndarë të vitit 2022, sipas vendimit të asamblesë së aksionarit datë 16.05.2023 si dhe raportit të audituesit të pavarur, kapitalet dhe rezervat do të jenë:

Kapitalet dhe Rezervat

Kapitali nënshkruar	847,490,000
Primi i lidhur me kapitalin	
Rezerva të tjera	
Rezerva ligjore	66,963
Rezerva statutore	
Rezerva zhvillimi	1,138,368
Rezerva të tjera	118,636,343
Fitimi (humbja) i pashpërndarë	
Fitimi (humbja) e periudhës	
	<b>967,331,674</b>

Struktura e kapitalit nuk ka ndryshuar pas zvogëlimit të kapitalit, po ashtu dhe numri i aksioneve. Kapitali i regjistruar i shoqërisë "ALBAFILM" Sh.A përbëhet nga 847.490 aksione me vlerë nominale 1.000 lekë/aksion.

Ky kapital zotërohet 100% nga Ministria e Kulturës.

Tiranë, Shqipëri  
 2 Gusht 2023



Elvira Hoxha CPA,  
 Auditues Ligjor  
 Lic. Nr.193 datë 28.12.2008





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
MINISTRI

Nr. 3809/Prot.  
11

Tiranë, më 25/7 /2023

VENDIM I ASAMBLESE TË AKSIONARIT

Nr. 3809/datë 25.7 .2023  
11

PËR

“EMËRIMIN E AUDITUESIT LIGJOR PËR KRYERJEN E VEPRIMEVE PËR  
ZVOGËLIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË ALBAFIL SH.A.”

Në mbështetje të ligjit nr.7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.711, datë 09.09.2020 “Për transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë”, ligjit nr.10091, datë 05.02.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, statutit të shoqërisë “ALBAFILM” Sh.a, me cilësinë e Titullarit të Institucionit, Ministria e Kulturës, aksioner i vetëm i Shoqërisë “ALBAFILMA” Sh.a përfaqësues e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë,

VENDOSA:

1. Emërimin e Audituesve Ligjorë, z.Olti Visha dhe znj. Elvira Hoxha, të cilët së bashku do të kryejnë veprimet e nevojshme për zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë Albafilm sh.a.
2. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë “ALBAFILM” Sh.a për zbatimin e këtij Vendimi.

*Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë*







BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE  
DREJTORIA E INVESTIMEVE TË PUNËVE PUBLIKE

Nr. 4722 prot.

Tiranë, më 2, 2, 2023

**Lënda: Për informacion**

**ALBAFILMIT**

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu" Nr.76, Tiranë

E nderuar znj. Aurora Polo, Administrator,

Bashkia e Tiranës ka lidhur kontratën e sipërmartjes me shoqërinë "5D Konstruksion" sh.p.k. & "Bami" sh.p.k., me objekt të saj "Rehabilitimi i Qendrës Kinostudio" me Nr. Prot. 33127/5, datë 07.12.2022, me afat të kryerjes së punimeve sipas kontratës 12 muaj kalendarikë, duke nisur nga data e lidhjes së kontratës.

Qëllimi i këtij projekti është rikonstruksioni i rrugës "Aleksandër Moisiu", sheshit dhe hapësirave publike, synon të rrisë sipërfaqet e gjelbërta, të krijojë ambiente rekreative, kënde për fëmijët, restaurimi i fasadave të banesave që ndodhen përreth sheshit, rehabilitimin e stacionit të autobusëve, si dhe rregullimin e qarkullimit në rrugët lidhëse.

Me qëllim realizimin e plotë të projektit, parashikohen prishje të disa objekteve, ku sipas planimetrisë së objekteve që prishen, preket pjesërisht territori edhe godina e Albafilmit.

Për sa më sipër, po ju dërgojmë planimetrinë e prishjeve të projekt zbatimit të objektit të mësipërm, të miratuar me VKT Nr. 11/5, Datë 19.07.2022.

Kërkojmë bashkëpunimin tuaj për vijimin e punimeve.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin tuaj,

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

Taulant Tusha



Nr. 36/2 prot

27.06.2023



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE  
DREJTORIA E INVESTIMEVE TË PUNËVE PUBLIKE

Nr. 23615 prot.

Tiranë, më 26, 6, 2023

Lënda: Për dijeni tuaj

MINISTRISË SË KULTURËS

Rruga "Aleksandër Moisiu", nr. 76, ish Kinostudio "Shqipëria e Re",  
Tiranë

ALBAFILM

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu" Nr.76, Tiranë

E nderuar znj. Zerina Bruçi, Sekretar i Përgjithshëm,

E nderuar znj. Aurora Polo, Administrator,

Në vijim të korrespondencës sonë për punimet me objekt "Rehabilitimi i Qendrës Kinostudio", punime të cilat po kryhen nga shoqëritë sipërmarrëse "SD Konstruksion" shpk & "Barni" sh.p.k., në zbatim të kontratës me Nr. Prot. 33127/5, datë 07.12.2022, ju vemë në dijeni se gjatë zbatimit të projektit është rishikuar projekt - zbatimi, për të cilin ju dërgojmë Vendimit e Këshillit Teknik me Nr. 9/1 datë 30.05.2023 të miratimit të tij.

Bashkëlidhur do të gjeni edhe projektin e rishikuar.

Ju falënderojmë për mirëkuptimin tuaj,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Pl. Cukaj

Taulant Tusha

eval



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE

DREJTORIA E INVESTIMEVE TË PUNËVE PUBLIKE

25575

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 13, 07, 2023

Lënda: Në vëmendjen T'uaj

ALBAFILM

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu" Nr.76, Tiranë

**Për dijëni:** Znj. Zerina Bruçi, Sekretar i Përgjithshëm  
Ministria e Kulturës

Z. Maringlen Qato, Kryeinspektor  
Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë

E nderuar znj. Aurora Polo, Administrator,

Në vijim të korespondencës sonë mbi punimet që po kryhen në objektin "Rehabilitimi i Qendrës Kinostudio" nga shoqëria "5D Konstruksion" shpk & "Bami" sh.p.k. në bazë të kontratës së sipërmarrjes me Nr. Prot. 33127/5, datë 07.12.2022, ju bëjmë me dije se nga ana e Drejtorisë sonë është miratuar projekti i rishikuar i këtij objekti me VKT nr. 9/1, datë 30.05.2023, për të cilën ju kemi bërë me dije me anë të shkresës sonë me Nr. 23615 Prot., datë 26.06.2023.

Për sa më sipër, në bazë të këtij projekti do të vijohet me prishjet e disa objekteve të ndodhura në territorin tuaj të cilat përcaktohen në planimetrinë e prishjeve të projekt zbatimit, për të cilat kërkohet bashkëpunimi i Institucionit tuaj, për të mos u bërë pengesë në realizimin në kohë të punimeve të këtij objekti.

Bashkëlidhur planimetria e prishjeve.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Taulant Tusha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQËRIA "ALBAFILM" Sh.a

Nr. 36/15 Prot.

Tiranë, më 18/042023

**Lënda:** Kërkesë për caktim eksperti për zvogëlim kapitali të shoqërisë ALBAFILM Sh.a.

**Drejtuar:** Ministrisë së Kulturës.

*Rruga Aleksandër Moisiu, Ish Kinostudio, Tiranë.*

Në kuadër të zbatimit të projektit "Rehabilitimi i qendrës Kinostudio", miratuar me Vendim të Këshillit Teknik nr.11/5 datë 19.07.2022 ALBAFILM Sh.a. u njoftua me shkresën nr.4722 prot, datë 02.02.2023 nga Bashkia Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike.

Gjithashtu me Vendimin e Këshillit Teknik nr.9/1 datë 30.05.2023 të Bashkisë Tiranë, ALBAFILM Sh.a. u vu në dijeni me shkresën nr.23615 prot date 26.06.2023.

Me shkresën nr.25575 prot, datë 13.07.2023 nga Bashkia Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike jemi njoftuar se do vijohet me prishjet e disa objekteve të ndodhuara në territorin tonë të cilat përcaktohen në planimetrinë e prishjeve të projekt zbatimit.

Meqenëse ALBAFILM Sh.a. i prishen 2 objekte nga zbatimi i projektit "Rehabilitimi i qendrës Kinostudio", kërkojmë emërimin e një eksperti Auditues Ligjor për kryerjen e veprimeve të nevojshme për zvogëlimin e kapitalit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

Bashkëlidhur:

Projekti i miratuar me VKT nr.11/5 datë 19.07.2022.

Shkresa nr.4722 prot, datë 02.02.2023.

Shkresa nr.23615 prot date 26.06.2023.

Projekti i miratuar me VKT nr.9/1 datë 30.05.2023.

Shkresa nr.25575 prot, datë 13.07.2023.

ADMINISTRATOR ALBAFILM Sh.a.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
MINISTRI

Nr. 2372 / Prot.

Tiranë, më 6/5 /2023

VENDIM I ASAMBLESË SË AKSIONARIT

NR. 298, datë 16.5 .2023

PËR  
MIRATIMIN E RAPORTIN E AUDITIMIT TË EKSPERTËVE KONTABËL DHE  
SHPËRNDARJEN E REZULTATIT FINANCIAR PËR VITIN 2022 TË SHOQËRISË  
"ALBAFILM" SHA TIRANË

Bazuar në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, V.K.M. nr.711 datë 09.09.2020, "Për transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë "ALBAFILM" Sh.a., Tiranë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë tek Ministria e Kulturës", si dhe statutin e shoqërisë ALBAFILM Sh.a., me cilësinë e Titullarit të Institucionit, Ministria e Kulturës, aksioner i vetëm i Shoqërisë "ALBAFILM" Sh.a përfaqësuese e Asamblessë së Përgjithshme të Shoqërisë,

VENDOSA:

- 1- Miratimin e Vendimit Nr.3 dt.17/03/2023 të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë "Albafilm" sh.a. për "Miratimin e Raportit të Eksperteve Kontabël për llogaritë vjetore të shoqërisë për vitin 2022"
- 2- Miratimin e shpërndarjes së rezultatit financiar për vitin ushtrimor 2022 në vlerën **1,339,257** (një milion e treqind e tridhjetë e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë e shtatë) Lekë si mëposhtë:
  - Rezervë ligjore 5% në vlerën **66,963** (gjashtë dhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tre) Lekë
  - Divident 10% në vlerën **133,926** (njëqind e tridhjetë e tre mijë e nëntëqind e njëzet e gjashtë) Lekë
    - Dega e Tatim Taksave 15% të Dividentit, në shumën **20,089** (njëzet mijë e tetëdhjetë e nëntë) Lekë
    - Buxheti i Shtetit 85% e Dividentit në vlerën **113,837** (njëqind e trembëdhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e shtatë) Lekë
  - Rezervë zhvillimi 85% në vlerën **1,138,368** (një milion e njëqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tetë) Lekë.

Likujdami i "Dividentit" të kryhet brenda muajit Qershor 2023.

- 3- Ngarkohet Administratori i Shoqërisë "ALBAFILM" Sh.a për zbatimin e këtij Vendimi, sipas legjislacionit në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

